



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Shtator 2022

Nr: 199

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË,
ZJ. SABRIE ISNI LACI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3788/1 prot., datë 02.08.2022, këshilli i bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Afrim Hysen Mikli, propozuar nga subjekti politik Partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 07, zj. Sabrie Isni Laci.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 40



Data: 29 Shtator 2022

Nr. 199

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zj. Sabrie Isni Laci

unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Sabrie Isni Laci, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 3050 prot., datë 11.08.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3049 prot., datë 11.08.2022 dhe shkresën nr. 3073 prot., datë 29.08.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Sabrie Isni Laci.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 8454/1 prot., datë 19.08.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Sabrie Isni Laci, në këshillin e bashkisë Dibër, ku konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit duke ndryshuar përbërësit e gjendjes civile nga “Zoku” në “Laci”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 9658/1 prot., datë 18.08.2022, dhe shkresën nr.10069/1 prot., datë 07.09.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Sabrie Isni Laci, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Sabrie Isni Laci, në këshillin e bashkisë Dibër nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zj. Sabrie Isni Laci.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

